Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR

MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (udhëheqës ekipi), Fatlinda Podvorica dhe Veton Misiri (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Shkëlqim Xhema.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm....7

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....13

4 Qeverisja e mirë....30

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....32

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA....42

Shtojca II: Letërkonfirmimi....44

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23/10/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç që MKRS gjatë vitit 2018 kishte realizuar pagesa në vlerë 390,455€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate, në Institutin Arkeologjik të Kosovës ishin realizuar pagesa në vlerë 273,913€, për punëtorët e angazhuar për punë në teren sipas një rregullore e cila ishte e shfuqizuar me vendim të qeverisë, subvencionet e dhëna në vlerë 153,864€ nuk ishin arsyetuar nga përfituesit e tyre si dhe pagesa në vlerë 163,363€ për paga dhe mëditje në mungesë të dëshmive për vijueshmërinë në punë.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë kapitale dhe jo kapitale të shpalosura në PFV nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të saktë, si dhe keq-klasifikimi i pagesave për vendimet gjyqësore.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Opinoni i Kualifikuar pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar ndodhjen e shpenzimeve si dhe pajtueshmërinë e pagesave me rregullat.	Ministri duhet të analizojë çështjet që ka ndikuar në kualifikimin e opinionit dhe Theksimin e Çështjes dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar përmirësimin e tyre. (shih nënkapitullin 2.1)
Menaxhimi Financiar dhe kontrollet e brendshme nuk kanë operuar në mënyrë efektive, janë identifikuar dobësi në të hyra, paga dhe mëditje, subvencione dhe transfere si dhe investime kapitale.	Ministri duhet të siguroj që janë ndërmarr veprimet konkrete për të siguruar kontrolle dhe menaxhim efektiv në fushat në të cilat janë identifikuar dobësitë. (shih nënkapitullin 3.1).
Dobësi janë identifikuara edhe në menaxhimin dhe kontrollet e brendshme që kanë të bëjnë me pasuritë dhe obligimet e papaguara.	Ministri duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave të identifikuara dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. (shih nënkapitujt 3.2 dhe 3.3).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimit menaxherial janë të dobëta.	Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate sa i përket menaxhimit të rreziqeve dhe harmonizimit të ligjeve. (shih nënkapitullin 4.2).

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të MKRS-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e MKRS-së, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Çështjet të cilat kanë ndikuar në bazën për opinion të kualifikuar janë si në vijim:

1. MKRS gjatë vitit 2018 kishte realizuar pagesa në vlerë 390,455€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate si:

    - Nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin realizuar pagesa në vlerë 341,656€ për shpenzime të cilat për nga natyra dhe sipas planit kontabël i takojnë kategorive tjera ekonomike. Prej tyre 171,614€ i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime siç janë rastet në vijim:

        - MKRS kishte kryer pagesa në vlerë 104,368€ për furnizim me interier për Muzeun e Kosovës;

- Pagesat në vlerë 44,550€ për zyrtarët e angazhuar të MKRS-së në komisione të ndryshme si dhe pagesa në vlerë 2,360€ për organizmin e javës evropiane të sportit;

- Pagesa për bileta të udhëtimit zyrtar për stafin e MKRS në vlerë 15,000€ dhe shpenzimet e akomodimit në vlerë 5,336€; si dhe

- Pagesat në vlerë 170,042€ për anëtarët e këshillave drejtues të institucioneve vartëse të MKRS. Këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë paga dhe mëditje.

➢ Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishin realizuar pagesa në vlerë 48,799€. Sipas nenit 12 pika 5 të ligjit Nr.06/L-20 për Buxhetin e vitit 2018, shpenzimi i parave publike nga kategoria mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve. MKRS gjatë vitit 2018 kishte paguar 27,190€, për punë shtesë për zyrtarët e saj të angazhuar jashtë orarit të rregullt të punës, që për nga natyra i takon kategorisë paga dhe mëditje. Ndërsa pagesat në vlerë 21,609€ i takonin kategorisë së subvencioneve dhe transfereve për mbështetje të personaliteteve nga fusha e sportit (pagesa e biletave të udhëtimit).

2. Pagesat në vlerë 273,913€ për punëtorët e angazhuar për punë në teren nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, janë bërë sipas rregullores nr. 01/2009 për pagesën e punëtorëve në teren e cila është e shfuqizuar me vendim të qeverisë. Kjo çështje është duke u përsëritur ndër vite për shkak se MKRS nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim përkundër faktit që IAK kishte hartuar një draft rregullore.

3. Subvencionet e dhëna në vlerë 153,864€ nuk ishin arsyetuar nga përfituesit e tyre. Sipas marrëveshjeve të nënshkruara, bartësit e projekteve obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e realizuara, në afat prej 30 ditësh pas realizimit të aktiviteteve të subvencionuara. Kjo kishte ndodhur për shkak të monitorimit jo të rregullt nga zyrtarët e MKRS-së dhe mos ndërmarrjes së masave ligjore ndaj përfitueseve të cilët nuk kishin raportuar.

4. Bazuar në marrëveshjen e Brukselit të dt.26.03.2015 dhe vendimit të Qeverisë Nr.06/39 i dt.22.07.2015, 31 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur ''Mbrojtja civile'' ishin caktuar në departamente të ndryshme të MKRS-së në veri të vendit. Për këta zyrtar, MKRS-ja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi siç janë: vijueshmëria në punë apo raporte për punën e kryer gjatë vitit 2018. Shpenzimet e pagave gjatë vitit 2018 ishin 163,363€.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga MKRS dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

1. Vlera e pasurisë e prezantuar në PVF për vitin 2018 nuk ishte e saktë për arsyet në vijim:

   - Vlera e pasurisë kapitale (mbi 1000 euro) në MKRS është 33,066,055€. Prej tyre, pasuria në vlerë prej 32,913,030€ apo 99% janë të paraqitura si investime në vijim. Lidhur me këtë, MKRS ende nuk ka bërë përparime sa i përket identifikimit, vlerësimit dhe regjistrimit të objekteve dhe pronave të saj, prandaj regjistri i pasurisë si i tillë ende konsiderohet jo i saktë. Për më tepër, MKRS nuk kishte ofruar informatat e nevojshme për testim të pasurive, të tilla si pronësia e pasurive, informata mbi projektet kapitale të përfunduara për të cilat duhet bërë transfere kapital në komuna përkatëse si dhe informata nëse projektet e tilla ishin investime të reja apo rinovim i pasurive ekzistuese;

   - Më tutje, pasuritë kapitale (mbi 1,000€) ishin nënvlerësuar për 1,592,908€, kjo pasi që disa pasuri të blera në vitin 2018 nuk ishin regjistruar me kohë dhe si të tilla janë regjistruar në vitin 2019. Pasiguria në lidhje me vlerën neto të pasurive vjen edhe për faktin që raporti i inventarizimit të pasurive nuk ishte harmonizuar me regjistrin e pasurive; dhe

   - Vlera e pasurisë jo kapitale (nën 1,000€) ishte mbivlerësuar për 403,530€. Vlera e prezantuar në PFV ishte 627,407€, ndërsa vlera sipas regjistrit e-pasuria ishe 223,877€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë me rastin e përgatitjes së pasqyrave.

2. Pagesat në vlerë prej 119,417€ për vendime gjyqësore kanë ndikuar në keq klasifikim të shpenzimeve në rastet në vijim:

   - Nga kategoria subvencione dhe transfere ishte realizuar pagesa në vlerë 104,435€, e cila për nga natyra i takonin kategorisë së investimeve kapitale; dhe

   - Nga kategoria e investimeve kapitale ishin realizuar pagesa në vlerë 14,982€ përderisa këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë paga dhe mëditje.

Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë dhe institucioneve vartëse.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MKRS-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve është menaxhuar në mënyrë të dobët. Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura tek baza për opinion të kualifikuar dhe theksim të çështjes jepen rekomandimet:

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet planifikohen dhe regjistrohen në kategori ekonomike adekuate dhe se nuk do të lejohen pagesa nga kategori tjera të shpenzimeve.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj që, në bashkëpunim me këshillin drejtues të Institutit Arkeologjik të Kosovës të hartojë politika apo udhëzime gjithëpërfshirëse për pagesën dhe angazhimin e punonjësve për realizimin e projekteve.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të OJQ-ve arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve.

Rekomandimi C2 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë është mjaft i përhapur edhe në ministritë tjera.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë dhe të njëjtat do të ofrohen tek ZKA. Për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komunat. Po ashtu, duhet të formojë komision të veçantë për identifikimin, vlerësimin e pronave dhe objekteve të MKRS. Raporti i inventarizimit duhet të harmonizohet me regjistrin e pasurisë dhe kjo të reflektojë në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Megjithëse, kishte përmirësime sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit gjatë vitit 2018, ku vlen të përmendet ndërprerja e transferimit të mjeteve në llogari të paautorizuara tek institucionet vartëse si dhe mbyllja e këtyre llogarive, ende nevojiten veprime shtesë për një menaxhim financiar dhe kontroll të mirëfilltë.

Në kontekst të sistemeve financiare, duhet të forcohen kontrollet mbi të hyrat dhe mbi një sërë fushash të shpenzimeve që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsitë dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë fusha e subvencioneve si fushë më shqetësuese për shkak të moszbatimit të kërkesave ligjore gjatë dhënies dhe monitorimit të tyre, pagat dhe mëditjet, menaxhimi i pasurisë, procedimi i pagesave, menaxhimi i kontratave si dhe raportimi dhe pagesa e obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**36,523,904**	**33,223,382**	**29,952,621**	**24,408,173**	**16,773,166**
Granti i Qeverisë -Buxheti	31,653,401	29,712,167	27,520,149	24,342,201	16,255,016
Të bartura nga viti paraprak1	0	22,407	7,947	15,579	26,520
Të hyrat vetjake2	70,503	70,503	23,166	36,675	26,671
Donacionet e brendshme	0	1,157	0	343	0
Donacionet e jashtme	0	117,149	28,050	13,375	464,959
Të hyrat nga AKP	4,800,000	3,300,000	2,373,308	0	0

[1] Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.
[2] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetiake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,300,522€. Ky është rezultat i shkurtimeve buxhetore me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2018, MKRS ka shpenzuar 90% të buxhetit final ose 29,952,621€, me një rënie prej 6% krahasuar me vitin 2017.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**36,523,904**	**33,223,382**	**29,952,621**	**24,408,173**	**16,773,166**
Pagat dhe Mëditjet	4,342,854	4,530,497	4,504,696	4,073,999	3,560,945
Mallrat dhe Shërbimet	1,280,986	1,917,969	1,703,542	1,453,497	1,363,229
Shërbimet komunale	404,908	387,222	317,331	343,867	308,555
Subvencionet dhe Transferet	8,166,550	12,013,990	10,734,320	8,583,046	7,060,865
Investimet Kapitale	22,328,606	14,373,704	12,692,732	9,953,762	4,479,572

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Rritja e buxhetit final për paga dhe mëditje në krahasim më atë fillestar ishte 187,643€. Kjo ishte rezultat i rritjes së buxhetit me vendim të Qeverisë për 177,031€ për harmonizimin e pagave, 9,880€ prej të hyrave të bartura të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe buxheti i bartur i grandeve nga "Fondi Global" prej 732€. Realizimi ishte 99% e buxhetit final;
- Në krahasim me buxhetin fillestar, te mallrat dhe shërbimet buxheti final ishte rritur për 636,983€. Rritja e buxhetit përfshin transferin nga investimet kapitale prej 450,000€, vendimin e Qeverisë nr. 04/45 të dt. 08/05/2018 për punëtorët me marrëveshje të veçanta për Rezidencën Ibrahim Rugova nga shpenzimet e paparashikuara të fondit rezervë për 57,944€, të hyrat e bartura në vlerë 12,526€ si dhe 116,513€ të tjera nga donatorët e jashtëm. Realizimi ishte 89% e buxhetit final;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte zvogëluar për 17,686€. Fillimisht kishte rritje të buxhetit nga fondi global për 25€ ndërsa më vonë ishte zvogëluar me vendim të Qeverisë nr.07/80 të dt.18/12/2018 për kursime buxhetore në vlerë 17,711€. Realizimi ishte 82% e buxhetit final;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 3,847,440€ krahasuar me atë fillestar. Fillimisht kishte rritje të buxhetit me vendime[3] të Qeverisë ku nga fondi rezervë ishin ndarë 855,613€ për organizmin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, si dhe 250,000€ për shënimin e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit. Pastaj, pas kërkesës së MKRS-së janë aprovuar nga Ministria e Financave dhe janë trasferuar nga investimet

[3] Vendimi Nr 03/29 dt. 13.02.2018 në vlerë 600,000€ dhe Vendimi Nr 07/64 dt. 11.09.2018 në vlerë 255,613€ Vendimi Nr 04/35 dt. 09.03.2018 në vlerë 250,000€

kapitale shuma prej 1,515,000€, me vendime të Qeverisë bazuar në nenin 15 të ligjit të buxhetit për vitin 2018 ishin transferuar 1,225,791€, rritja nga donacionet e jashtme 898€ dhe fondi global 138€. Realizimi ishte 89% e buxhetit final; dhe

- Buxheti final i investimeve kapitale ishte zvogëluar për 7,954,902€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo ishte si rezultat i transfereve në linjat tjera buxhetore në vlerë 2,878,528€ dhe reduktimit me vendime të Qeverisë në vlerë 5,076,374€. Realizimi ishte 88% e buxhetit final.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MKRS në 2018 ishin në vlerë 59,663€. Këto të hyra janë realizuar nga Arkiva Shtetërore 16,184€, nga IMM Prizreni 14,641€, Biblioteka Kombëtare e Kosovës 15,632€, Teatri Kombëtarë 12,967€ si dhe nga administrata qendrore e MKRS 239€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (€)

Përshkrimi	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	59,663	85,330	50,785
Totali	**59,663**	**85,330**	**50,785**

Në raport me vitin e kaluar kemi një zvogëlim të të hyrave për 25,667€, për arsye se vitin e kaluar kishte shitje të automjeteve.

Lidhur më testet tonë, ne kemi identifikuar çështjen si në vijim:

Çështja A2[4] - Shfrytëzimi i objektit të trashëgimisë kulturore pa leje nga Institucioni Kompetent

Gjetja

Sipas nenit 6 pika 6.14 të Ligjit Nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturore: Përdorimi me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor i trashëgimisë arkitekturore autorizohet me leje të shkruar nga Institucioni Kompetent, në rastet kur vlerat e trashëgimisë kulturore, janë të mbrojtura.

Në një rast kemi vërejtur që objekti "Mulliri i Pintollit'' në Prizren që i përket MKRS –Trashëgimisë Kulturore shfrytëzohet pa shpallje publike dhe pa leje të shkruar nga Institucioni kompetent. Kontrata e parë e nënshkruar nga pala që e shfrytëzon Mullirin dhe Instituti për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren (tani QRTK –Prizren) është nënshkruar në vitin 2004 kur nuk ka pasur ligj për trashëgimi kulturore dhe si e tillë ishte ri-përtrirë nga drejtorët në periudha të caktuara deri në vitin 2011. Pastaj, nga viti 2011 e tutje ky objekt shfrytëzohet pa kontratë valide, megjithëse pala/shfrytëzuesi i këtij objekti vazhdon të paguaj shumën vjetore të qirasë prej 2,000€, dhe se vazhdimisht kishte bërë përpjekje me anë të kërkesave të nënshkruaj një kontratë mbi qiranë me MKRS-në, mirëpo kjo nuk ishte arritur deri me tani.

Kjo ka ndodhur pasi që MKRS nuk kishte bërë shpallje publike për dhënien në shfrytëzim të aseteve të Trashëgimisë Kulturore në përputhje me Ligjin për trashëgimi.

Rreziku

Lejimi i shfrytëzimit të objekteve të trashëgimisë kulturore pa kontratë apo leje ku do të specifikoheshin kushtet për shfrytëzimin e këtyre objekteve rrit rrezikun e dëmtimit të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe njëherësh rrit rrezikun që të hyrat e realizuara nga dhënia me qira të jenë më të ulta si rezultat i një procesi jo konkurrues. Gjithashtu edhe operimi me kontratë të skaduar privon MKRS-në nga e drejta për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e proceduarve gjyqësore në raste të mos inkasimit të borxhit me kohë apo dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të siguroj që dhënia në shfrytëzim e objekteve që i përkasin trashëgimisë kulturore bëhet përmes shpalljes publike, ku fillimisht duhet të përcaktohen kriteret për shfrytëzimin e këtyre objekteve.

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MKRS-së, e të cilat ndërlidhen me autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me thesarin etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Përveç çështjes te nënkapitulli 2.1 (Baza për Opinion), ne kemi identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja C3 – Dobësi në angazhimin e stafit sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta

Gjetja

Sipas nenit 12 pika 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

MKRS (përfshirë institucionet vartëse) ka angazhuar 129 zyrtarë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MSHV) prej tyre 12 janë të punësuar në Rezidencën Presidenciale ''Dr. Ibrahim Rugova'' në pozita (ciceron, roje, mirëmbajtëse, zyrtar për protokoll), 16 në Bibliotekën Kombëtare, 4 në Agjencinë e Arkivit Shtetëror të Kosovës dhe pjesa tjetër prej 97 në MKRS. Lidhur me këto, ne kemi identifikuar dobësi si në vijim:

- Në 43 raste, Ministria nuk ka zbatuar ndonjë procedurë të rekrutimit sipas kërkesave ligjore; dhe
- 86 zyrtarë të angazhuar me MSHV kishin vazhduar nga vitet paraprake, vetëm se gjatë vitit 2018 i janë nënshtruar procedurës së thjeshtësuar të rekrutimit. Pra periudha e angazhimit të këtyre zyrtarëve është më e gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla, mbi gjashtë muaj.

Sipas zyrtarëve të MKRS kjo kishte ndodhur për shkak të nevojës për staf shtesë sidomos sa i përket pozitave të nivelit mbështetës tek institucionet vartëse dhe mos aprovimit të buxhetit për staf shtesë.

Rreziku

Dobësitë e identifikuara mund të rezultojnë me mungesë të mirëfilltë të konkurrencës dhe cilësi të dobët të shërbimeve të ofruara. Në mungesë të kontrolleve Ministria rrezikon rritje të shpenzimeve të pa planifikuar që mund të ndikojnë në ngecjen e realizimit të objektivave tjera të përcaktuara.

Rekomandimi C3 Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në Ministri (pozita të rregullta) të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm duke kaluar përmes sistemit të pagave.

Çështja C4 - Mos ndalja e tatimit në burim për të ardhurat personale

Gjetja Neni 38 i Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhura Personale, përcakton që "Secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara të punëtorëve të tij, duke përfshirë edhe pagesat për zyrtarët e angazhuar me kontratat për shërbime të veçanta.

Megjithatë, ne kemi vërejtur se në 20 raste për zyrtarët e angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta, ku shpenzimet e pagave ishin 30,926€, ministria nuk kishte mbajtur tatimin në burim. Prej tyre 16 raste i takojnë Bibliotekës Kombëtare (BKK) dhe 4 raste Agjencisë Shtetëror të Arkivave të Kosovës (ASHAK).

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive të stafit lidhur me kërkesat e ligjit.

Rreziku Mos mbajtja në burim e tatimit në paga është detyrim ligjor për secilin punëdhënës dhe mund të rrezikoj MKRS-në që të jetë subjekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore. Më tutje, kjo ndikon edhe në mbledhjen e të hyrave të përgjithshme shtetërore.

Rekomandimi C4 Ministri respektivisht kryeshefat përkatës duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar kompetencën profesionale të stafit në mënyrë që të zbatohen kërkesat ligjore sa i përket ndaljes së tatimit në burim për të punësuarit me kontratë për shërbime të veçanta.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2018 ishte 2,305,191€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,020,872€. Këto shpenzimet kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, mirëmbajtje, pajisje të IT-së, derivate, shpenzime të qirasë, shërbime kontraktuese, shërbime komunale etj.

Për më gjerësisht, referojuni nënkapitullit 2.1 (Baza për Opinion).

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 12,013,990€. Prej tyre në vitin 2018 ishin shpenzuar 10,734,320€ apo 89%. Përmes kësaj kategorie, ministria mbështet financimin e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

MKRS-ja deri në muajin gusht të vitit 2018 kishte ndarë subvencione për të financuar aktivitetet bazë të Institucioneve vartëse, ku mjetet transferoheshin në llogaritë e paautorizuara të këtyre institucione të cilat më pastaj shfrytëzoheshin për aktivitete të ndryshme të tyre. Kjo praktik është ndërprerë pas raportit të ZKA-së për vitin 2017 dhe si rezultat ishin kthyer mjetet në llogari të thesarit në vlerë 708,038€.

Përveç çështjes te nënkapitulli 2.1 (Baza për Opinion), ne kemi identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja A3 – Planifikimi jo i mirë dhe mangësi në realizim të pagesave

Gjetja

Sipas rregullës financiare Nr.01/2013/MF- Shpenzimi i parave publike, nenit 25, zyrtari certifikues nuk do ta certifikojë dokumentacionin për pagesë, nëse kushtet e dhëna më poshtë nuk janë plotësuar: 1) Të posedoj zotimin/kërkesën për blerje, shpalljen e tenderit, kontratën, urdhër blerjen, raportin e pranimit dhe fatura e pranuar. 2) Të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur, 3) Kërkesa për pagesë ka kodin e duhur të nën-artikullit të shpenzimit në klasifikimin e shpenzimeve, si dhe janë zbatuar të gjitha nivelet e kontrollit të brendshëm financiar.

Gjatë vitit 2018, me vendime të Qeverisë[5] ishin ndarë mjete financiare në vlerë 855,000€ për realizimin e pagesave për shpenzimet e shërbimeve dhe furnizimeve të ndryshme me rastin e festimit të 10 Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

Për këto shpenzime, ne kemi testuar 9 pagesa në vlerë 668,502€ dhe kemi vërejtur se MKRS nuk kishte lidhur paraprakisht ndonjë kontratë apo marrëveshje me operatorët ekonomik (OE) ku do të përcaktoheshin shërbimet apo punët që do të realizoheshin si dhe çmimet që do të paguhen për to.

Kjo kishte ndodhur pasi që Qeveria nuk kishte planifikuar me kohë në Ligjin e Buxhetit për vitin 2018 manifestimin e 10 vjetorit të pavarësisë si dhe për shkak se komisioni për organizimin e 10 Vjetorit të Pavarësisë ishte formuar nga qeveria dhe nuk kishte koordinim të duhur me MKRS-në.

Rreziku

Planifikimi jo i mirë dhe realizimi i aktiviteteve në mungesë të kontratave të definuara qartë për shërbimet dhe çmimet që do të kryhen, rrit rrezikun që kostoja e shërbimeve të pranuara të jetë më e lartë sesa kostoja e tregut, dhe njëherësh mund të rezultojë në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj se aktivitetet e caktuara dhe buxheti për realizimin e tyre planifikohen me kohë. Njëherit para realizimit të aktiviteteve duhet të zhvillohen procedurat përkatëse, në mënyrë që në kontrata/marrëveshje përcaktohen qartë shërbimet që do të realizohen si dhe çmimi i tyre.

[5] Vendimi Nr 03/29 dt. 13.02.2018 në vlerë 600,000€ dhe Vendimi Nr 07/64 dt. 11.09.2018 në vlerë 255,613€

Çështja C5 - Pagesat për kompensimin e stafit për punë shtesë

Gjetja

Neni 80 i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, citon: nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

MKRS-ja kishte anashkaluar kërkesat ligjore duke kompensuar stafin e angazhuar në komisione të ndryshme[6] gjatë orarit të rregullt të punës. Vlera totale e këtyre kompensimeve ishte 35,200€ të cilat ishin paguar nga kategoria subvencione dhe transfere dhe ishin realizuar me aprovim të ZKA-së.

Shkaku i këtyre kompensimeve sipas menaxhmentit të MKRS-së ishte motivimi i stafit, pasi që në mungesë të kompensimit stafi hezitojnë të angazhohen në komisione të tilla.

Rreziku

Pagesat për kompensimin e stafit për punë shtesë brenda orarit të rregulltë të punës është në kundërshtim me legjislacionin duke rezultuar me pagesa të parregullta dhe njëkohësisht ndikon në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi C5

Ministri duhet të sigurojë se nuk do të ketë asnjë kompensim shtesë për stafin e angazhuar brenda orarit të rregullt.

[6] Komisionet për sponsorizime, për vlerësimin e projekteve etj.

Çështja A4 - Mangësi në shqyrtimin e kërkesave për subvencionim

Gjetja

MKRS bazuar në politikat programore subvencionon aktivitet sportive të federatave të sportit, klubeve të sportit etj, për aktivitete të ndryshme siç janë masivizimi i sportit, ndërkombëtarizimi i sportit etj. Sipas rregullores MF. Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, neni 10 - aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim: të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asocimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës; të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës etj.

Në pagesën në vlerë 20,000€, kemi vërejtur se kishte mangësi sa i përket aprovimit të kërkesës së bërë me dt. 26/07/2018 nga OJQ - AKADEMIA BASKET ABA, për mbështetje financiare për pjesëmarrjen në "Champions League" për klubin e basketbollit SIGAL Prishtina. Këto dy OJQ, kishin një marrëveshje ku përcaktohej që sponsorusit e klubit të basketbollit mund t'i derdhin mjetet financiare në llogarinë bankare të Akademisë Basket, dhe se kjo e fundit ishte e autorizuar të kryej pagesa në emër të Klubit të basketbollit Prishtina.

Si e tillë, kërkesa ishte e paqartë pasi që sipas saj Klubi i basketbollit SIGAL PRISHTINA emrin ligjor e ka AKADEMIA BASKET ABA, mirëpo nuk janë ofruar dëshmi me të cilat vërtetohet emërtimi të cilit i referohet. Ne kemi konfirmuar se në regjistrin e OJQ-ve në Ministrin e Administratës Publike këto dy OJQ janë të regjistruara si subjekte të ndara. Po ashtu, kërkesa për subvencionimin e aktivitetit fillimisht ishte refuzuar nga zyrtari i sportit pasi që kërkesa kishte ardhur në emër të AKADEMIA BASKET ABA.

Përkundër këtyre paqartësive, kjo kërkesë ishte aprovuar më tutje nga menaxhmenti i MKRS-së edhe pse nuk kishte një arsyetim të qartë për mënyrën e lidhjes së kontratës për subvencionim me AKADEMIA BASKET ABA, për një aktivitet i cili zhvillohet nga Klubi i basketbollit SIGAL Prishtina dhe si ky projekt do të zbatohej.

Rreziku

Aprovimi i kërkesës dhe ndarja e mjeteve për mbështetje financiare në mungesë të arsyetimeve të qarta lidhur me procesin e zbatimit dhe qëllimet e projektit rrit rrezikun e menaxhimit të buxhetit dhe ekzekutimit të parregullt të pagesave.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë që aprovimet nga menaxhmenti i kërkesave të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e aplikuesve, e që në këto raste nuk bëhen pa konfirmimin e përfituesit të fundit të fondeve dhe se është bërë një analizë e detajuar për arsyet e përdorimit të këtyre fondeve duke përgatitur një raport të veçantë për t'u siguruar se mjetet janë përdorur për qëllimet e dhëna.

Çështja C6 - Arsyetimi i dobët i shpenzimeve nga federatat

Gjetja

Sipas memorandumit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet MKRS-së dhe Federatës së Shahut të Kosovës me dt.28/03/2018, MKRS-ja mbështet financiarisht federatën e shahut në vlerë 39,160€ për realizimin e objektivave të synuara të saj për vitin 2018. Sipas këtij memorandumi pagesa bëhet për çdo periudhë tremujore nga 9,790€, pas raportimit me shkrim për shpenzimin e mjeteve sipas realizimit të aktiviteteve sportive për periudhën paraprake.

Në një rast, kemi vërejtur se arsyetimi i shpenzimeve për tremujorin e parë të vitit 2018 nga federata e shahut ishte bërë me fatura të vitit 2017, bazuar në raportin dhe faturat e ofruara.

Kjo kishte ndodhur pasi që federatës së shahut ju kishte marrur buxheti nga përmbaruesi në tre mujorin e katërt të vitit 2017 për shkak të mos kryerjes së obligimeve të saj.

Rreziku

Aprovimi i shpenzimeve të tremujorëve duke ofruar fatura të shpenzimeve të cilat janë krijuara në periudha të mëhershme, rrit rrezikun e pagesave të parregullta dhe mos arritjes së objektivave të synuara.

Rekomandimi C6

Ministri duhet të sigurohet se aprovimi i shpenzimeve për subvencione bëhet vetëm pas sigurimit të dëshmive se shpenzimi i mjeteve nga përfituesit janë bërë në përputhje me objektivat e dakorduara dhe për periudhën kohore të specifikuar në memorandumin e bashkëpunimit.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2018 ishte 14,373,704€, ndërsa ishin shpenzuar 12,692,732€ apo 88%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e palestrave sportive, qendrave kulturore, rinore dhe gërmimeve arkeologjike etj.

Lidhur më testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja A5 – Pagesa e paradhënies pa siguruar garancinë e performancës

Gjetja

Sipas nenit 13 të ligjit të buxhetit për vitin 2018, organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale deri në 15% të vlerës së kontratës. Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë.

Në kontratën për ndërtimin e palestrës sportive në Komunën e Deçanit – faza e tretë në vlerë 549,865€, MKRS kishte kryer pagesën e paradhënies në vlerë prej 82,479€ apo 15% operatorit ekonomik pa sjellë garancionin e performancës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Rreziku

Pagesa e paradhënies pa siguruar garancinë e performancës përveç që janë në kundërshtim më ligjin e buxhetit ato rrisin rrezikun që operatori ekonomik të mos realizoj punimet sipas kontratës apo të mos realizoj fare punimet. Njëherit kjo mund t'i shkaktoj shpenzime të mëdha MKRS-së për mbylljen e kontratës në fjalë dhe kthimin e mjeteve të paguara si paradhënie, në rast të dështimit të saj.

Rekomandimi A5

Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme lidhur me pagesën e paradhënieve dhe se ato bëhen vetëm pas plotësimit të kritereve të përcaktuara me ligjin e buxhetit.

Çështja A6 - Vonesat në përfundimin e projekteve kapitale

Gjetja

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet MKRS-së dhe operatorëve ekonomik për realizimin e projekteve kapitale përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve sipas planit dinamik dhe gjithashtu parashihet aplikimi i ndëshkimeve në rast të vonesave të paarsyetuara.

Në katër raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë. Përfundimi i punimeve për këto raste do të duhej të ishte brenda vitit 2018 mirëpo, këto ende nuk kishin përfunduar deri prill 2019. Rastet e identifikuara janë:

- 'Ndërtimi i Palestrës Sportive' në Deçan – faza e tretë, vlera e kontratës 549,865€ e nënshkruar me dt.15/12/2017, duhej të përfundonte në qershor të vitit 2018;
- 'Renovimi i Qendrës së Kulturës - Hasan Prishtina" në Skenderaj, vlera e kontratës 197,393€ e nënshkruar me dt. 26/07/2017, duhej të përfundonte në korrik 2018, pastaj me lidhjen e aneks kontratës në vlerë 19,515€ ishte zgjatur afati i realizimit deri më 24/10/2018;
- 'Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës' në Obiliq, vlera e kontratës 748,340€ e nënshkruar me dt. 12/12/2016, duhej të përfundonte me dt. 13/12/2017. Për më tej, me lidhjen e aneks kontratës me datë 02/10/2018 në vlerë 72,069€ ishte zgjatur afati i realizimit edhe për 90 ditë nga data e nënshkrimit të aneks kontratës. Megjithatë ende nuk janë përfunduar punimet;
- 'Restaurimi i Shtëpisë së Xhavit Devës', vlera e kontratës 115,001€, e nënshkruar me dt. 03/01/2018, duhej të përfundonte brenda 120 ditëve kalendarike;

Lidhur me këtë, nga zyrtarët e MKRS-së nuk kemi marr ndonjë sqarim të qëndrueshëm për vonesat e realizimit të projekteve.

Rreziku

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MKRS të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi A6

Ministri duhet të siguroj se janë analizuar shkaqet që kanë ndikuar në mos realizimin e punimeve sipas planeve dinamike. Dhe krahas tyre të ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore.

Çështja A7 – Realizimi i punimeve shtesë në mungesë të aneks kontratës

Gjetja

Neni 10.2 i kushteve të veçanta në kontratën 'Renovimi i stadiumit olimpik - Adem Jashari" në Mitrovicë e nënshkruar me dt.27.04.2017 në vlerë 1,493,219€, përcakton që, nëse gjatë ekzekutimit të punimeve, konstatohet nga trupa e organit mbikëqyrës se nevojiten punime shtesë të cilat mund të vërtetohen, atëherë punimet shtesë mund të procedohen nga autoriteti kontraktues me kërkesë nga kontraktuesi, të aprovuar nga trupa e organit mbikëqyrës. Punimet shtesë do ti nënshtrohen procedurës përkatëse siç kërkohet me dispozitat ligjore në vijim:

Rregullat dhe procedurat e prokurimit publik, pika 61.22 përcakton që aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit; pika 61.23 Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para: (a) Marrjes së aprovimit nga ZKA; (b) Zotimit të mjeteve për kontratën e amandamentuar; dhe pika 61.25 Asnjë ndryshim kontrate nuk do ta shtojë çmimin total të kontratës më shumë se 10 % të çmimit fillestar të kontratë.

Tek kontrata e cekur më lartë, kemi vërejtur se janë realizuar punë shtesë prej 10% të kontratës bazë duke mos respektuar kushtet e veçanta të kontratës dhe kërkesat ligjore për aprovimin e punimeve shtesë. Për këtë, nuk kishte aneks kontratë të nënshkruar. Vlera totale e pagesave për këtë projekt përfshirë punët shtese dhe shpenzimet e përmbaruesit ishin në vlerë 1,689,289€.

Lidhur me shkakun e realizimit të punëve shtesë pa aprovim paraprak tek ky projekt, tregon që kishte mungesë të kontrollit dhe koordinimit brenda MKRS-së.

Rreziku

Realizimi i punimeve shtesë pa aneks kontratë është në kundërshtim me kërkesat ligjore si dhe rrit rrezikun që të realizohen punime të panevojshme duke e dëmtuar buxhetin e MKRS-së. Kjo do të ndikojë në rritjen e obligimeve të paplanifikuara.

Rekomandimi A7

Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme lidhur me aprovimin e punimeve shtesë dhe të sigurojë se në rastet kur paraqitet nevoja për punë shtesë respektohen procedurat ligjore siç parashihet me kontratë.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja C7 - Lidhja e kontratave duke anashkaluar procedurat e prokurimit

Gjetja

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 me plotësim ndryshime, lidhja e kontratave për furnizim me mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale duhet të realizohen përmes procedurave të prokurimit publik. Po ashtu, sipas këtij ligji këto kontrata duhet të nënshkruhen nga drejtori i prokurimit.

Megjithatë, në rastet në vijim kemi vërejtur se lidhja e kontratave nuk ishte në harmoni me LPP-në:

- Muzeu i Kosovës gjatë vitit 2018 kishte nënshkruar tri kontrata për furnizim me interier në vlerë totale 269,440€ pa zbatuar ndonjë procedurë të prokurimit. Këto kontrata ishin nënshkruar nga drejtori i Muzeut të Kosovës;

- MKRS kishte nënshkruar nëntë kontrata me media për shërbimet e mediave për mbulimin e aktiviteteve të ministrit/MKRS-së pa aplikuar ndonjë procedurë të prokurimit. Këto kontrata ishin nënshkruar nga ZKA, ku çmimet e tyre ishin mujore dhe varësisht shërbimeve të kryera; dhe

- MKRS, me rastin e organizimit të javës evropiane të sportit nga data 23-30 shtator 2018 kishte angazhuar një kompani për realizimin e videove që përfshinë xhirimet, audio, montazh dhe post produksioni. Më tutje, kontrata në vlerë 2,360€ ishte lidhur me dt.31.10.2018, pas përfundimit të aktivitetit si dhe pa zbatuar ndonjë procedurë prokurimi. Kjo kontratë ishte nënshkruar nga udhëheqësi i departamentit të sportit.

Këto kishin ndodhur për shkak të anashkalimit të procedurave të prokurimit nga MKRS dhe Muzeu i Kosovës.

Rreziku

Kontraktimi i shërbimeve në mungesë të procedurave të prokurimit, ndikon në zvogëlimin e konkurrencës dhe diskriminon ofruesit tjerë të shërbimeve të tilla. Po ashtu, kjo mund të rezultojë me një kosto më të lartë të këtyre shpenzimeve.

Rekomandimi C7

Ministri duhet të ndërmerr masa për të vlerësuar ligjshmërinë e këtyre kontratave si dhe për të vlerësuar nëse shërbimet e kontraktuara janë ekonomike dhe sigurojnë vlerën për paranë e shpenzuar. Njëherësh të sigurohet që ZKA dhe Zyrtarët tjerë vartës të mos nënshkruajnë kontrata në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 33,066,000€, vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) është prezantuar 627,000€, ndërsa stoqet ishin në vlerë prej 910€. Vlera e pasurisë e prezantuar në PVF nuk është e saktë.

Për më gjerësisht, referojuni kapitullit 2.1(Theksimi i çështjes).

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 3,084,380€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Krahasuar me vitin paraprak 2017 ku vlera e obligimeve ishte 2,262,000€, këtë vit obligimet janë rritur për 36%. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Ministria. Ndërsa vlera e detyrimeve kontigjente ishte 194,623€.

Lidhur me testet tona, ne kemi identifikuar si në vijim:

Çështja A8 - Mos protokollimi i faturave

Gjetja

Sipas nenit 37, paragrafi 2 i rreg. Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, ZKF është përgjegjës që të krijoj mekanizma të cilat mundësojnë regjistrimin e faturave të pranuara dhe të përcjellë procedimin për pagesë të këtyre faturave. Ndërsa sipas nenit 24, paragrafi 1.3, të gjitha faturat duhet të protokollohen dhe të evidentohet në librin e faturave.

Lidhur me këto, ne kemi identifikuar që MKRS nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit të faturave, ngase faturat e pranuara nuk protokollohen dhe nuk evidentohen në librin e faturave, përveç faturave të pranuara në departamentin e sportit, Agjencioni i Arkivit dhe Bibliotekës Kombëtare.

Këto parregullsi kanë ndodhur pasi që, MKRS nuk ka vendosur mekanizma të cilët mundësojnë regjistrimin e faturave të pranuara dhe procedimin me kohë të tyre për pagesë.

Rreziku

Mos zbatimi i procedurave të kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit të faturave që kanë të bëjnë me protokollimin dhe evidentimin e tyre në librin e faturave si dhe procedimit për pagesë, rrit rrezikun për raportim jo të saktë të obligimeve, vonesave në kryerjen e pagesave dhe rrjedhimisht rritjes së kostos për shkak të ekzekutimit të pagesave përmes procedurave gjyqësore.

Rekomandimi A8

Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur mekanizma të cilët mundësojnë protokollimin e faturave të pranuara, evidentimin e tyre në librin e faturave dhe procedimin për pagesë brenda afatit kohorë ligjorë.

Çështja B3 - Raportim jo i plotë i obligimeve

Gjetja

Sipas nenit 17, paragrafi 3 i rreg. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore, Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor te vitit raportues. Po ashtu, sipas rreg. Nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara, organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave të raportojnë në baza mujore faturat e pranuara dhe të papaguara. Më tutje, sipas nenit 39 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, organizata buxhetore duhet çdo faturë të vlefshme ta paguajnë brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës.

Lidhur me raportimin e obligimeve të papaguara, ne kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Nga 46 mostrat e testuara për faturat e paguara në vitin 2019 (periudha janar-shkurt) të cilat ishin obligime të vitit 2018, ne kemi konstatuar se 21 fatura në vlerë totale prej 10,814€ nuk ishin të shpalosura në PFV të vitit 2018 si obligimeve të papaguara;

- Raportet mujore për obligimet e papaguara të dorëzuara në MF nga MKRS nuk ishin të plota pasi që në asnjërin raportim mujor gjatë vitit 2018 nuk ishin përfshirë obligimet nga fusha e subvencioneve dhe investimeve kapitale; dhe

- Në 25 raste, faturat apo obligimet ndaj furnitorëve në vlerë totale 433,724€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga 5 deri në 420 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak se ZKF nuk ka vendosur mekanizma të kontrollit për të siguruar një raportim të plotë të obligimeve.

Rreziku

Raporti jo i plotë i obligimeve të pa paguara, si dhe tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund të rezultojë me humbje të faturave dhe rrjedhimisht MKRS nuk do të ketë informacionin e duhur dhe në kohë lidhur me obligimet paraprake. Po ashtu, MKRS mund të jetë subjekt i ekzekutimeve të pagesave direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të jenë të prezantuara drejtë në raportin e obligimeve. Është i nevojshëm të bëhet një plan ku parashihet buxheti dhe veprimet konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të akumuluara.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave. Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse MKRS ka arritur disa përmirësime, ende ekziston një numër i dobësive veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe menaxhimin e rrezikut. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk ishin vendosur plotësisht. Veprim i mirë konsiderohet ndërprerja e transferimit të mjeteve nga MKRS në llogari të paautorizuar të institucioneve vartëse dhe mbyllja e këtyre llogarive pas raportit të auditimit të ZKA-së për vitin 2017 duke rezultuar me kthimin e mjeteve në vlerë 708,038€ në llogari të thesarit.

Megjithatë, mbetet sfidë monitorimi i institucioneve vartëse, të cilat edhe pse raportojnë në ministri, nuk kanë menaxhim të mirë financiar. Kontrollet ishin të dobëta në menaxhimin e shpenzimeve e posaçërisht në subvencione. Më tutje, mungesa e një strategji të përgjithshme të objektivave tregon nevojën për përmirësime shtesë në këtë fushë.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë kryesisht, mos respektimin e plotë të rregulloreve në fuqi në fushat e subvencioneve, menaxhimin e projekteve kapitale, menaxhimin e obligimeve dhe fusha e personelit të cilët janë trajtuar në kapitujt më lartë.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë- Drejtori i NjAB-së dhe një auditor. Për vitin 2018, NjAB kishte hartuar Planin vjetor të punës bazuar në rreziqe, ku kishte planifikuar dhe kryer pesë (5) auditime. Në këto auditime ishin mbuluar edhe institucionet vartëse[7] të MKRS, për të cilat ishin përgatitur planet e zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së. Po ashtu komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta gjatë kësaj periudhe.

[7] Teatri Kombëtar i Kosovës, Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Filharmonia e Kosovës

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëj me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet apo masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Lidhur me këtë ne kemi identifikuar si në vijim:

Çështja C8 – Mungesa e politikave të shkruara dhe procedurave për menaxhimin e rreziqeve

Gjetja

Procedura e MFK-së nr.4, përcakton që secila organizatë buxhetore duhet të vendos politika të shkruara si dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve.

Për këtë, MKRS nuk ka politika të shkruara dhe as procedura për menaxhimin e rreziqeve. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, ku do të bëhej identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos trajtimit me prioritet nga menaxhmenti për të vendosur këto politikave dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut.

Rreziku

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut ndikon në cilësinë e objektivave pasi që rreziqet nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi C8

Ministri duhet të sigurojë se do të trajtoj me prioritet vendosjen e politikave të shkruara dhe procedurave për menaxhimin e rreziqeve për të reduktuar ndikimin e tyre në nivele të pranueshme. Njëherit duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

Çështja B4 - Mos harmonizim i ligjeve dhe bartja e përgjegjësisë pa mbështetje ligjore

Gjetja

Ligjet organike me të cilat rregullohet veprimtaria e Institucioneve vartëse të kulturës në MKRS janë të vjetra dhe të pa ndryshuara asnjëherë, si të tilla në shumë raste janë në konflikt me ligjet e përgjithshme mbi bazën e të cilave duhet të funksionojë ministria. Drejtorët e këtyre institucioneve raportojnë në departamentin e kulturës edhe pse Ligji për Administratën Shtetërore, Rregullorja për Standardet e Organizimit të Administratës Shtetërore dhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MKRS, e përcaktojnë shumë qartë se të vetmet njësi organizative që departamentet mund t'i kenë në vartësi, janë divizionet e përafërta.

Ndërsa, sa i përket kornizës ligjore të institucioneve të trashëgimisë kulturore, ato nuk janë të rregulluara me ligje të veçanta organike, dhe raportojnë tek Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në MKRS. Veprimtarinë e tyre e bazojnë në ligjin për trashëgiminë kulturore (përveç Muzeut të Kosovës, i cili bazohet në ligjin për institucionet e kulturës).

Në bazë të këtij rregullimi, këto institucione nuk kanë të drejtë të kenë kode buxhetore dhe të menaxhojnë me buxhetin e tyre, mirëpo këto duhet të kryhen nga ana e ministrisë.

Rreziku

Mos-harmonizimi i ligjeve organike me ligjet e përgjithshme rezulton me probleme në menaxhimin e punës së institucioneve vartëse dhe rrezikon efektivitetin e menaxhimit administrativ dhe financiar si dhe krijon paqartësi në linjat e raportimit. Po ashtu, bartja e përgjegjësisë për menaxhim dhe shpenzim të buxhetit tek institucionet e trashëgimisë kulturore mund të rezultojë në shmangie të kontrolleve të brendshme dhe shpenzimeve të parregullta.

Rekomandimi B4

Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit organik të institucioneve vartëse me legjislacionin e përgjithshëm për organizimin e administratës dhe për menaxhimin e financave publike. Po ashtu, menaxhimi dhe shpenzimi i buxhetit të institucioneve të trashëgimisë kulturore duhet të bëhet nga departamentet përkatëse në ministri.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 kishte rezultuar në 30 rekomandime. Për këto, MKRS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Megjithatë, deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, 16 rekomandime ishin zbatuar, shtatë ishin pjesërisht, katër ishin të përsëritura si dhe tre konsiderohen të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Thesarin duhet të gjejnë alternativa të përshtatshme që pagesat nga këto institucione vartëse të kryhen përmes llogarive të thesarit.	Pas raportit të auditimit për vitin 2017 janë mbyllur llogaritë e paautorizuara të institucioneve vartëse.	I zbatuar.
2		Ministri duhet të siguroj që, në bashkëpunim me këshillin drejtues të IAK të hartojë politika apo udhëzime gjithëpërfshirëse për pagesën dhe angazhimin e punonjësve për realizimin e projekteve.	MKRS nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e këtij rekomandimi përkundër faktit që IAK kishte hartuar një draft rregullore e cila nuk është shqyrtuar dhe aprovuar nga MKRS.	I përsëritur.
3		Ministri duhet të siguroj që kontrollet lidhur me shpenzimin e parasë publike janë duke funksionuar, ashtu që pagesat për projektet kapitale të realizohen në përputhje të plotë me Rregullën Financiare të Thesarit 01/2013 Për Shpenzimin e Parasë Publike.	Ky rekomandim ndërlidhet me transferet e mjeteve në llogari të institucioneve vartëse prandaj konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar.
4		Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e Institucioneve Vartëse, Federatave dhe OJQ-ve duhet të arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve.	Me përjashtim të projektet e institucioneve vartëse dhe federatave, MKRS edhe më tutje ka mbetur pa zbatuar pjesa e rekomandimi për arsyetimin e subvencioneve nga OJQ-të .	Pjesërisht i zbatuar.

5		Ministri duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë dhe të njëjtat do të ofrohen tek ZKA. Për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komunat. Po ashtu, duhet të formojë komision të veçantë për identifikimin, vlerësimin e pronave dhe objekteve të MKRS. Raporti i inventarizimit duhet të harmonizohet me regjistrin e pasurisë dhe kjo të reflektojë në PFV.	Edhe më tutje pasuritë regjistrohen dhe ende kanë mbet si investime në vijim, pavarësisht nga rekomandimi i viti të kaluar.	I përsëritur.
6	Procesi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit në mënyrë që mos të ketë përshtatje dhe diferenca të theksuara ndërmjet planifikimit dhe shpenzimit të mjeteve. Po ashtu është e nevojshme që të bëhen përpjekje për ndarjen e nën kodeve buxhetore të veçanta për secilin Institucion vartës të kulturës në mënyrë që Institucionet të planifikojnë buxhetin e tyre. Përveç kësaj, duhet të merren masat e nevojshme në mënyrë që të realizohen të gjitha projektet kapitale të parapara me buxhet si dhe të mos merren obligime financiare përmes marrëveshjeve derisa paraprakisht nuk janë siguruar mjetet.	MKRS këtë vit kishte ndërmarr masa për këtë rekomandim duke bërë analizë të faktorëve që kishin ndikim në realizim të buxhetit.	I zbatuar.
7	Pagat dhe Shtesat	Ministri duhet të shqyrtojë rastet e identifikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin do të bëhet komfor kontratave valide dhe rregulloreve në fuqi.	Gjatë vitit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar.
8		Ministri duhet të sigurojë se kategorizimi i pozitave të Drejtorëve në Institucionet Vartëse të bëhet në përputhje me mandatin e tyre dhe me ligjet përkatëse të institucioneve vartëse.	Gjatë vitit 2018 MKRS është në proces të kategorizimit të këtyre pozitave.	I mbyllur.
9	Menaxhimi i personelit	Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta angazhohen me procedura rekrutuese sipas kërkesave ligjore.	MKRS për stafin e angazhuar me MSHV gjatë vitit 2018 kishte zhvilluar procedurat e rekrutimit konform	Pjesërisht i zbatuar.

			kërkesave ligjore, mirëpo edhe më tutje mbetet tejkalimi i afatit ligjor.	
10	Mallrat dhe Shërbimet	Ministri duhet të siguroj se nuk do të ketë kompensime shtesë për shërbimet që janë pjesë e detyrave të obligueshme të postit që mbajnë punonjësit e ministrisë. Gjithashtu duhet të siguroj se të gjitha pagesat kryhen sipas ligjeve përkatëse.	Gjatë testimeve tona, nuk kemi identifikuar raste të ngjashme.	I zbatuar.
11		Ministri duhet të siguroj që plani i prokurimit të përfshijë në një kontratë mallrat, shërbimet si dhe furnizimet e njëjta. Për çdo furnizim, komisionet të autorizohen dhe raportet e pranimit të përmbajnë informatat e nevojshme që dëshmojnë se mallrat e paguara janë pranuar në përputhje me sasinë dhe cilësinë e kontratës përkatëse.	MKRS ka zbatuar këtë rekomandim lidhur me planin e prokurimit si dhe për furnizimet janë formuar komisionet dhe raportet e pranimit përmbanin informata të nevojshme.	I zbatuar.
12	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet te siguroj që secili vendim për subvencionim do të përmbajë shumën totale të financuar për aktivitetin e caktuar dhe do të jetë komfor rregullores së brendshme.	Vendimet për subvencione përmbanin shumën e financuar sipas rregullores së brendshme.	I zbatuar.
13		Ministri duhet të sigurohet që respektohen të gjitha kriteret e rregullores së brendshme me rastin e financimit të Federatave dhe të mos financohet kësti tjetër pa u arsyetuar tërësisht këstet paraprake. Gjithashtu të siguroj se, vendimet për dhënien e subvencioneve do të merren para realizimit të projekteve dhe mos të jepen subvencione për projektet që tashmë janë realizuar.	Ende nuk është adresuar plotësisht rekomandimi. Ka dobësi në arsyetimin e shpenzimeve.	Pjesërisht i zbatuar.

14		Ministri duhet që të hartojë rregullore gjithëpërfshirëse për kompensimin e të angazhuarve në projektet e Baletit, dhe se , kompensimi për të angazhuarit e jashtëm të bëhet vetëm përmes llogarisë bankare. Po ashtu tatimet dhe kontributet e të angazhuarve duhet të mbahen në burim sipas kërkesave ligjore si dhe furnizimet nga institucionet vartëse duhet ti nënshtrohen procedurave formale të prokurimit.	Ende nuk është zbatuar pjesa e rekomandimit që ka të bëjë me ndaljen në burim të tatimit dhe kontributeve dhe lidhjes së kontratave përmes procedurave të prokurimit. Për më tepër ref. kapitullit 3.1.2 .	Pjesërisht i zbatuar.
15		Ministri duhet të siguroj se përkrahen vetëm projektet dhe aktivitetet e subjekteve që janë në përputhje të plotë me kriteret e rregullores se brendshme të subvencioneve.	MKRS ka përkrahur projektet dhe aktivitetet e subjekteve sipas kritereve për subvencione.	I zbatuar.
16		Ministri duhet të sigurohet që monitorimi nga zyrtarët të jetë i rregullt për subvencionet e dhëna dhe të respektohen afatet ligjore për raportimin e shpenzimeve të shfrytëzuara nga përfituesit e projektit.	MKRS nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë është dhënë rekomandimi te kapitullit 2.3.	I mbyllur.
17		Ministri duhet te sigurohet që në të ardhmen mjetet për financimin e projekteve të OJQ-ve të derdhen në llogaritë bankare të OJQ-ve (personave juridik) që subvencionohen. Të sigurohet gjithashtu se OJQ-të financohen vetëm në rast të kërkesave valide dhe të kenë kontratë të nënshkruar me përfituesin e subvencionit.	MKRS ka zbatuar këtë rekomandim, mjetet janë transferuar në llogaritë bankare të OJQ sipas kërkesave me kontratë apo marrëveshje.	I zbatuar.
18		Ministri duhet të vendos kontrolle buxhetore më të forta dhe të sigurojë që shpenzimet bëhen në përputhje me qëllimin dhe planifikimin e tyre në mënyrë që të sigurohet shpenzim adekuat i buxhetit dhe klasifikim i duhur i shpenzimeve.	Në vitin 2018 për anëtarët e këshillave drejtues kemi dhënë rekomandim A1, ndërsa për komisionet kemi dhënë rekomandimin C5.	Pjesërisht.

19	Investimet Kapitale	Ministri duhet të siguroj se për secilin aktivitet të përkufizuar në LPP, do të aplikohen procedurat e prokurimit. Po ashtu, duhet të siguroj që kontrollet lidhur me shpenzimin e parasë publike janë duke funksionuar, ashtu që pagesat të realizohen në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.	MKRS edhe me tutje në disa raste ka vazhduar në lidhjen e kontratave pa aplikuar procedura të prokurimit.	Pjesërisht i zbatuar.
20		Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kontratat lidhen me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Bazuar në testet tona, ne kemi konstatuar që MKRS ka lidhur kontratat me OE të cilët i kanë plotësuar kriteret.	I zbatuar.
21		Ministri duhet të siguroj se procedurat e negociuara të prokurimit pa publikim të njoftimit të kontratës, aplikohen vetëm nën kushtet e parapara në LPP.	Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme.	I zbatuar.
22		Ministri duhet të siguroj që përgatitjes së planit të prokurimit t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e tij në mënyrë që mos të ketë devijime të theksuara në mes të kontratave të realizuara në raport me ato të planifikuara.	Bazuar në testet tona nuk kemi identifikuar raste te ngjashme.	I zbatuar.
23	Çështjet e përbashkëta për të gjitha kategoritë	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha marrëveshjet e mirëkuptimit/ bashkëpunimit nënshkruhen nga ai dhe jo nga SP, apo në të kundërtën të autorizojë SP për bartjen e kësaj përgjegjësie.	MKRS ka zbatuar këtë rekomandim, për këtë nuk kemi identifikuar raste të ngjashme.	I zbatuar.
24		Ministri duhet të sigurojë se MKRS do të respektojë kërkesën ligjore sa i përket deklarimeve në ATK, në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave të faturave fiktive, apo ajo e ndëshkimeve të mundshme	MKRS ka zbatuar këtë rekomandim duke bërë deklarimet në ATK.	I zbatuar.
25		Ministri dhe Drejtori i Thesarit duhet të sigurojnë që të mos paguhen fatura të papranuara/pa protokolluara nga MKRS dhe pa u konfirmuar marrja e mallrave apo shërbimeve.	Bazuar në testet tona, për pagesat e bëra kishte konfirmim që janë pranuar mallrat dhe shërbimet.	I zbatuar.

26	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të jenë të prezantuara drejtë në raportin e obligimeve. Është i nevojshëm të bëhet një plan ku parashihet buxheti dhe veprimet konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të akumuluara.	MKRS nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e këtij rekomandimi. Për më tepër ref. kapitullit 3.4.	I përsëritur.
27	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm (AP), me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Menaxhmenti kishte bërë përpjekje që ti adresoj rekomandimet tona, por edhe më tutje duhet të këtë angazhim në mënyre që të zbatohen plotësisht.	I mbyllur.
28	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj aktivitete të mjaftueshme të NjAB mbi institucionet vartëse të MKRS dhe përfundimin e planit vjetor të auditimit. Linjat llogaridhënëse brenda ministrisë duhet të rishikohen, në mënyrë që NjAB të raportojë tek Ministri. Po ashtu duhet të ndërmarrë veprime pro aktive në adresimin e rekomandimeve të NjAB duke përgatitur një plan të veprimit për implementimin e tyre.	MKRS ka zbatuar këtë rekomandim duke përfshirë në planin vjetor edhe institucionet vartëse të saj.	I zbatuar.
29	Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura për institucionet vartëse dhe të zbatojë aranzhime më të mira për arritjen e objektivave të specifikuara brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, MKRS duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Ky rekomandim ka mbetur i pa zbatuar vetëm pjesa sa i përket hartimit të regjistrit të rreziqeve.	Pjesërisht i zbatuar.

30		Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit organik të institucioneve vartëse me legjislacionin e përgjithshëm për organizimin e administratës dhe për menaxhimin e financave publike. Po ashtu menaxhimi dhe shpenzimi i buxhetit të institucioneve të trashëgimisë kulturore duhet të bëhet nga departamentet përkatëse në ministri.	MKRS nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e këtij rekomandimi. Për më tepër ref. kapitullit 4.2.	I përsëritur.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet planifikohen dhe regjistrohen në kategori ekonomike adekuate dhe se nuk do të lejohen pagesa nga kategoria për kategori tjera të shpenzimeve.		
2		Ministri duhet të siguroj që, në bashkëpunim me këshillin drejtues të Institutit Arkeologjik të Kosovës të hartojë politika apo udhëzime gjithëpërfshirëse për pagesën dhe angazhimin e punonjësve për realizimin e projekteve.		
3		Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të OJQ-ve arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve.		
4		Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë është mjaft i përhapur edhe në ministritë tjera.		
5		Ministri duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë dhe të njëjtat do të ofrohen tek ZKA. Për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komunat. Po ashtu, duhet të formojë komision të veçantë për identifikimin, vlerësimin e pronave dhe objekteve të MKRS. Raporti i inventarizimit duhet të harmonizohet me regjistrin e pasurisë dhe kjo të reflektojë në PFV.		
6	Të Hyrat	Ministri duhet të siguroj që dhënia në shfrytëzim e objekteve që i përkasin trashëgimisë kulturore bëhet përmes shpalljes publike, ku fillimisht duhet të përcaktohen kriteret për shfrytëzimin e këtyre objekteve.		

7	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në Ministri (pozita të rregullta) të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm duke kaluar përmes sistemit të pagave.
8		Ministri respektivisht kryeshefat përkatës duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar kompetencën profesionale të stafit në mënyrë që të zbatohen kërkesat ligjore sa i përket ndaljes së tatimit në burim për të punësuarit me kontratë për shërbime të veçanta.
9	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se aktivitetet e caktuara dhe buxheti për realizimin e tyre të planifikohen me kohë. Njëherit para realizimit të aktiviteteve duhet të bëhet lidhja e kontratave ku përcaktohen qartë shërbimet që do të realizohen dhe çmimi i tyre.
10		Ministri duhet të sigurojë se nuk do të ketë asnjë kompensim shtesë për stafin e angazhuar brenda orarit të rregullt.
11		Ministri duhet të sigurojë që aprovimet nga menaxhmenti i kërkesave të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e aplikuesve, e që në këto raste nuk bëhen pa konfirmimin e përfituesit të fundit të fondeve dhe se është bërë një analizë e detajuar për arsyet e përdorimit të këtyre fondeve duke përgatitur një raport të veçantë për t'u siguruar se mjetet janë përdorur për qëllimet e dhëna.
12		Ministri duhet të sigurohet se aprovimi i shpenzimeve për subvencione bëhet vetëm pas sigurimit të dëshmive se shpenzimi i mjeteve nga përfituesit janë bërë në përputhje me objektivat e dakorduara dhe për periudhën kohore të specifikuar në memorandumin e bashkëpunimit.
13	Investimet Kapitale	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme lidhur me pagesën e paradhënieve dhe se ato bëhen vetëm pas plotësimit të kritereve të përcaktuara me ligjin e buxhetit.
14		Ministri duhet të siguroj se janë analizuar shkaqet që kanë ndikuar në mos realizimin e punimeve sipas planeve dinamike. Dhe krahas tyre të ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore.
15		Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme lidhur me aprovimin e punimeve shtesë dhe të sigurojë se në rastet kur paraqitet nevoja për punë shtesë respektohen procedurat ligjore siç parashihet me kontratë.

16	Çështjet e përbashkëta Mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale	Ministri duhet të ndërmerr masa për të vlerësuar ligjshmërinë e këtyre kontratave si dhe për të vlerësuar nëse shërbimet e kontraktuara janë ekonomike dhe sigurojnë vlerën për paranë e shpenzuar. Njëherësh të sigurohet që ZKA dhe Zyrtarët tjerë vartës të mos nënshkruajnë kontrata në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.
17	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të jenë të prezantuara drejtë në raportin e obligimeve. Është i nevojshëm të bëhet një plan ku parashihet buxheti dhe veprimet konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të akumuluara.
18		Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur mekanizma të cilët mundësojnë protokollimin e faturave të pranuara, evidentimin e tyre në librin e faturave dhe procedimin për pagesë brenda afatit kohorë ligjorë.
19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rreziqeve	Ministri duhet të sigurojë se do të trajtoj me prioritet vendosjen e politikave të shkruara dhe procedurave për menaxhimin e rreziqeve për të reduktuar ndikimin e tyre në nivele të pranueshme. Njëherit duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.
20		Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit organik të institucioneve vartëse me legjislacionin e përgjithshëm për organizimin e administratës dhe për menaxhimin e financave publike. Po ashtu menaxhimi dhe shpenzimi i buxhetit të institucioneve të trashëgimisë kulturore duhet të bëhet nga departamentet përkatëse në ministri.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe

gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH ANS SPORTS

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. **Kujtim Gashi** .....

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Data: 14.06.2019, Prishtinë